



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 38

Tiranë – E mërkurë, 18 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 12/2015 datë 26.2.2015	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”..... 1741
Ligj nr. 14/2015 datë 26.2.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Islandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat..... 1742
Ligj nr. 15/2015 datë 5.3.2015	Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian..... 1754
Vendim i Kuvendit nr. 37/2015, datë 12.3.2015	Për emërimin e zotit Pajtim Melani anëtar i bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në funksionin e kryetarit të bordit..... 1759
Rezolutë e Kuvendit datë 5.3.2015	Për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri..... 1760



LIGJ
Nr. 12/2015

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 10 440, DATË 7.7.2011,
“PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT
NË MJEDIS”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. “Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis”, më poshtë “Deklarata mjedisore”, është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar.”

2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Autoritet i planifikimit” ka kuptimin që jepet në legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit.”

3. Pika 15 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 7, pikat 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“4. Metodologjia kombëtare e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

5. Rregullat, përgjegjësitë dhe afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.”

Neni 3

Në nenin 10, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë ministrisë, e cila ia përcjell AKM-së, dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë.”

Neni 4

Në nenin 11, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Vendimi i AKM-së për VNM-në paraprahe i dërgohet ministrisë, i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit vendimin.”

Neni 5

Në nenin 12, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Deklarata mjedisore i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit deklaratën mjedisore.”

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Transferimi i vendimit apo i deklaratës mjedisore”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kur zhvilluesi ndryshon pasi ka përfunduar procedura e VNM-së, zhvilluesi i ri kërkon pranë ministrisë të bëhet transferimi përkatës i vendimit apo deklaratës mjedisore, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, referuar në pikën 5, të nenit 7, të këtij ligji.”

Neni 7

Në nenin 16, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Informacionin për informimin dhe konsultimin me publikun zhvilluesi e paraqet si pjesë të dokumentacionit të nevojshëm gjatë aplikimit për deklaratën mjedisore në ministri.”

Neni 8

Në nenin 19, emërtimi “QKL” zëvendësohet me emërtimin “ministra”.



Neni 9

Në nenin 23, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur ministria gjykon se një projekt i propozuar mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e një apo më shumë shteteve fqinje ose kur merr një kërkesë nga një shtet tjetër, ndjek procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis në kontekst ndërkuftar.”.

Neni 10

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Certifikata dhe licenca për hartimin e raportit të VNM-së

1. Zhvilluesi, për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së, ngarkon personin fizik/juridik të licencuar nga QKL-ja, sipas kategorisë III.2.A të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Të drejtën për t'u pajisur me licencë III.2.A e kanë:

a) personi fizik i certifikuar nga ministri;

b) personi juridik, administratori i të cilit është i certifikuar nga ministri dhe ka të punësuar të paktën 2 ekspertë të certifikuar nga ministri.

3. Personi fizik/juridik i licencuar harton raportin e VNM-së duke krijuar grup specialistësh të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raportin e VNM-së. Raporti i VNM-së nënshkruhet nga personi fizik/juridik i licencuar dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së.

4. Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën.”.

Neni 11

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Çdo palë e interesuar, subjekt i këtij ligji, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative te ministri ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të ministrisë dhe AKM-së, sipas Kodit të Procedurave Administrative.”.

Neni 12

Në nenin 26, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rast të paraqitjes mbi 3 herë të raporteve të VNM-së me dobësi/mangësi, bazuar në metodologjinë kombëtare për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri vendos pezullimin e përkohshëm apo heqjen e certifikatës dhe njofton QKL-në për masën përkatëse.”.

Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 2 dhe të pikës 4, të nenit 10, të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet në datën 1 shtator 2015.

Miraturar në datën 26.2.2015

Shpallur me dekretin nr. 8994, datë 13.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 14/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
ISLANDËS PËR SHMANGIEN E
TATIMIT TË DYFISHTË DHE
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL
PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Islandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.2.2015

Shpallur me dekretin nr. 8995, datë 13.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
ISLANDËS PËR SHMANGIEN E TATIMIT
TË DYFISHTË DHE MËNJANIMIN E
EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME
TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Qeveria e Islandës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

me dëshirën për të përfunduar një Marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe mënjanimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Personat e përfshirë

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat të cilët janë rezidentë në një ose në dy Shtetet Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet e përfshira

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat, të vëna në emër të një Shteti Kontraktues ose të autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato mblidhen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vëna mbi të ardhurat totale, ose elementë të të ardhurave, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Marrëveshja janë veçanërisht:

a) në Islandë:

i) tatimet mbi të ardhurat për shtetin (*tekniskattar ríkissjóðs*); dhe

ii) tatimet mbi të ardhurat për bashkitë (*útsvar til sveitarfélaganna*); (këtu quhen “tatime islandeze”;

b) në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat (duke përfshirë tatimet mbi fitimet e korporatave dhe tatimet mbi të ardhurat personale); dhe

ii) tatimi mbi veprimtaritë e biznesit të vogël; (këtu quhen “tatime shqiptare”).

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëjtë ose në thelb të ngjashëm që është vendosur pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëri - tjetrin në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termi “Islandë” nënkupton Islandën dhe, kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Islandës, duke përfshirë detin e saj territorial, dhe çdo zonë tej detit territorial brenda së cilës Islanda, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ushtron juridiksionin ose të drejtat sovrane në lidhje me shtratin detar, nëntokën dhe ujërat mbi të dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas legjislacionit të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi “person” nënkupton një individ, shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

d) termi “shoqëri” nënkupton çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

e) termi “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një



Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

f) termi “një Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë Islandën ose Shqipërinë, siç e kërkon konteksti;

g) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion që kryhet nga një ndërmarrje që e ka vendin e saj të menaxhimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija ose avioni operojnë vetëm midis vendndodhjeve në Shtetin tjetër Kontraktues;

h) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në rastin e Islandës, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;

ii) në rastin e Shqipërisë, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;

i) termi “shtetas” nënkupton:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që e marrin statusin si të tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Për sa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

Neni 4 Rezident

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person i cili sipas ligjeve të atij Shteti, u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë Shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që u nënshtrohen tatimeve në atë Shtet, në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në atë Shtet.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja Shtetet Kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme; nëse ka një

banesë të përhershme në të dyja Shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike);

b) nëse Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë Shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit ku ka banesën e zakonshme;

c) nëse ka një banesë të zakonshme në të dyja Shtetet ose në asnjë prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit, ku është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dyja Shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të Marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv.

Neni 5

Seli e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurorë ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me të, por vetëm kur ky shesh, projekt ose aktivitet vazhdon për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë muaj, në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës, dhe

b) dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të



angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që përbëjnë më shumë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të vazhimit nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteve të përmendura në nënparagrafët a) deri e), me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe ushtron rregullisht në një Shtet Kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë një seli të përhershme në atë Shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë Shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim

të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre. Megjithatë, nëse aktivitetet e një agjenti të tillë i përkushtohen plotësisht ose pothuaj plotësisht në emër të asaj ndërmarrjeje, ai nuk konsiderohet të jetë një agjent me status të pavarur sipas kuptimit të këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri, rezidente në një Shtet Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri e cila është rezidente në Shtetin tjetër Kontraktues, ose që ushtron biznes në Shtetin tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose tjetër), nuk përbën në vetvete shoqëri dhe as seli të përhershme të shoqërisë tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme

1. Të ardhurat që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që gjenden në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në Shtetin tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin sendet aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të përdorura për realizimin e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë



Shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznesin si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër, por vetëm për ato që i takojnë asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirrite nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e së cilës ajo është, në secilin Shtet Kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra në Shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose diku tjetër.

4. Për sa kohë që është e zakonshme në një Shtet Kontraktues të përcaktohen fitimet që i atribuohen një selie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë Shtet Kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të tatohen nga kjo ndarje, siç mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë fitim nuk i atribuohet një selie të përhershme vetëm për shkak të blerjes nga ajo seli e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen selisë së përhershme përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar detar dhe ajror

1. Fitimet nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të një ndërmarrjeje transporti detar është në bordin e një anijeje, ai konsiderohet të gjendet në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i regjistrimit të anijes ose nëse nuk ka port regjistrimi, në Shtetin Kontraktues në të cilin operatori i anijes është rezident.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

Neni 9

Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në lidhje me marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim, që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohet përkatësisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti dhe taton përkatësisht fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në atë Shtet tjetër dhe kur fitimet e përfshira janë fitimet, të cilat do t'u ishin shtuar ndërmarrjes së Shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së tatimeve



të vëna në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultohen me njëri - tjetrin.

Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një firmë (e ndryshme nga një ortakëri) që zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese caktojnë mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime si dhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit në të cilin shoqëria që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë Shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën janë paguar dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazën fikse. Në këtë rast zbatohen

sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

5. Kur një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij Shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën janë paguar dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme ose një bazë fikse të vendosur në atë Shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë Shtet tjetër.

Neni 11 Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një Shtet Kontraktues dhe i paguar një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të jetë i tatueshëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritet kompetente të Shteteve Kontraktuese caktojnë me marrëveshje reciproke mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi i përmendur në paragrafin 1 do të jetë i tatueshëm vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin marrësi është rezident, nëse pronari përfitues i interesit është ai Shtet ose Banka Qendrore, një nënndarje politike ose një autoritet lokal i tij.

4. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga bonot ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë premiet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, bonove dhe dëftesave të borxhit. Gjobat për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllimet e këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke



qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një Shtet Kontraktues kur paguesi është vetë Shteti, një nënndarje politike e tij, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi konsiderohet të lindë në Shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që lindin në një Shtet Kontraktues dhe të përfituara në pronësi nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa të licencave mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 10 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese caktojnë me

marrëveshje reciproke mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “tarifat e licencave” siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filma kinematografikë dhe regjistrimet në shirita për transmetim radiofonik ose televiziv, çdo patentë, markë tregtare, dizenjo ose model, plan, formulë sekrete ose proces ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen tarifat e licencave, është e lidhur efektivisht me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Tarifat e licencave konsiderohen të lindin në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan tarifat e licencave, rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën është shkaktuar detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa përballohen nga kjo seli e përhershme ose vend fiks, atëherë këto tarifa do të konsiderohen të lindin në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur selia e përhershme ose vendi fiks.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave të licencave, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe që ndodhin në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në Shtetin tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pasurisë së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të taten në Shtetin tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar, ose pasurisë së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e përfuara nga tjetërsimi i aksioneve të kapitalit aksionar të shoqërisë ose të një interesi në një ortakëri ose trust, pasuria e të cilit përbëhet drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në një Shtet Kontraktues, mund të taten në Shtetin tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie, të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

6. Dispozitat e paragrafëve 4 dhe 5 nuk cenojnë të drejtën e një Shteti Kontraktues për të vjelë, sipas ligjit të vet, një tatim mbi fitimet nga tjetërsimi i aksioneve ose të drejtave në një shoqëri, kapitali i së cilës ndahet tërësisht ose pjesërisht në aksione dhe që në bazë të ligjeve të atij Shteti është rezident i atij Shteti, i përftuar nga një individ që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe ka qenë shtetas i Shtetit të parë kontraktues gjatë pesë viteve të fundit para tjetërsimit të aksioneve ose të drejtave.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat që përfitohen nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç rrethanave të mëposhtme kur këto të ardhura mund të taten edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse që i vihet atij rregullisht në dispozicion në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të tij; në atë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të taten në atë Shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që arrijnë apo tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; në atë rast, vetëm ajo sasi të ardhurash që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë Shtet tjetër, mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, auditëve dhe contabilistëve.

Neni 15

Të ardhurat nga punësimi

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përfitohet atje mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të jetë i tatueshëm vetëm në Shtetin e përmendur më parë, nëse:

a) marrësi është i pranishëm në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe



b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i Shtetit tjetër, dhe;

c) shpërblimi nuk përballohet nga një seli e përhershme ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në Shtetin tjetër;

d) punësimi nuk është rasti i ofrimit të fuqisë punëtore për të tjerët.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përfutur në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operon në trafikun ndërkombëtar mund të tatohet në atë Shtet Kontraktues në të cilin gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

Neni 16

Tarifat e drejtuesve

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve të një shoqërie, e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në Shtetin tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në rolin e subjektit argëtues si teatër, film, artist radioje ose televizioni ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij/saj personale të ushtruara në këtë mënyrë në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një subjekt argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti por nga person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e subjektit argëtues apo sportistit.

Neni 18

Pensionet

1. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të ngjashme të paguara një rezidenti të një Shteti Kontraktues duke marrë parasysh punësimin e shkuar, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

2. Megjithatë, këto pensione ose shpërblime të tjera të ngjashme mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku ato lindin dhe nëse këto pagesa nuk i nënshtrohen tatimit në Shtetin tjetër Kontraktues në bazë të rregullave të zakonshme të ligjit tatimor.

Neni 19

Shërbimi qeveritar

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, përveç pensioneve, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose një autoritet lokal i tij një individ i lidhje me shërbimet e kryera për atë Shtet ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë Shtet dhe nëse individ i është rezident i atij Shteti dhe:

i) është shtetas i atij Shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij Shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Pensionet e paguara nga ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues ose autoritet lokal i tij për një individ nga shërbimet e kryera në atë Shtet ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është rezident dhe shtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për rrogat, pagat, dhe shpërblime të tjera të ngjashme dhe pensionet, në lidhje me shërbimet e kryera në lidhje me një biznes të zhvilluar nga një Shtet Kontraktues ose autoritet lokal i tij.

Neni 20

Studentët dhe stazhierët

1. Pagesat që një student ose stazhier biznesi merr, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në Shtetin Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në Shtetin e parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, për qëllimet e mbështetjes ekonomike, edukimit ose trajnimit të tij nuk do të tatohen në atë Shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij Shteti.

2. Në lidhje me grandet, bursat dhe shpërblimet nga punësimi që nuk mbulohet nga paragrafi 1, një



student ose stazhier biznesi i përshkruar në paragrafin 1, po ashtu, gjatë arsimimit ose trajnimit ka të drejtë për të njëjtat përjashtime, lehtësime ose zbritje në lidhje me tatimet që zbatohen për rezidentët e Shtetit që ai viziton.

Neni 21

Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që lindin, të patrajuara në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga prona e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

Neni 22

Dispozita të ndryshme

Pavarësisht dispozitave të neneve të tjera të kësaj Marrëveshjeje, një rezident i një Shteti Kontraktues nuk merr përfitim nga asnjë zbritje ose përjashtim nga tatimi i parashikuar në Marrëveshje nga Shteti tjetër Kontraktues, nëse qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore të këtij rezidenti ose personi të lidhur me këtë rezident është marrja e përfitimeve nga kjo Marrëveshje.

Neni 23

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Nëse një rezident i një Shteti Kontraktues përfiton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues, Shteti i parë Kontraktues lejon si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e paguar mbi ato të ardhura në Shtetin tjetër.

Megjithatë, kjo zbritje në asnjë rast nuk kalon atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat që llogaritet para se të bëhet zbritja, që u përket, sipas rastit, të ardhurave që mund të taten në Shtetin tjetër.

2. Nëse në pajtim me një dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e përfutuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues janë të përjashtuara nga tatimi në atë Shtet, ky Shtet, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

Neni 24

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit të Shtetit tjetër Kontraktues apo çdo kërkesë në lidhje me të që ndryshon ose është më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse ndaj të cilave shtetasit e atij Shteti tjetër nënshtrohen ose mund të nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë zbatohet edhe ndaj personave të cilët nuk janë rezidentë të një ose të dy Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi mbi një seli të përhershme, që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë Shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij Shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyruese për një Shtet Kontraktues për t'u dhënë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues çdo zbritje financiare personale, lehtësira dhe ulje për qëllime tatimore, duke marrë parasysh statusin civil ose përgjegjësitë familjare, të cilat ua jep rezidentëve të vet.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 5 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të Shtetit të përmendur më parë.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohen asnjë tatimi në Shtetin e përmendur



më parë dhe asnjë kërkesë në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat e ngjashme të cilave mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur më parë.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 25

Procedura e Marrëveshjes së Ndërsjellë

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 23, mund t'ia paraqesë autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse mendon që kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim mënjanimin e tatimit që nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje. Çdo Marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjin e brendshëm të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes. Ata gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri - tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë për qëllimin e arritjes së një Marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese shkëmbejnë informacionin e parashikuar të nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin të caktuar në emër të Shteteve Kontraktuese, ose të nën ndarjeve të tyre politike apo autoriteteve lokale në masën që, tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë në bazë të paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues trajtohet konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përfutur sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen sa më sipër. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në procedime gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një Shtet Kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të një Shteti tjetër Kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përfutur sipas ligjeve ose në punën normale të administratës në atë ose një Shtet tjetër Kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues në pajtim me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues zbaton masat e veta për mbledhjen e informacionit për të përfutur informacionin e kërkuar, edhe nëse Shteti tjetër mund të mos e kërkojë këtë informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi i parashikuar në fjalinë e



mësipërme i nënshtrahet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen për të lejuar një Shtet Kontraktues për të mos dhënë informacion thjesht pasi ai nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen sikur lejojnë një Shtet Kontraktues për të mos dhënë informacion thjesht pasi informacioni zotërohet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar ose person që vepron në një agjenci ose një cilësi besimi ose pasi ai ka të bëjë me interesat e pronësisë së një personi.

Neni 27

Anëtarët e misionëve diplomatike dhe posteve konsullore

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të cenojë privilegjet fiskale të anëtarëve të misionëve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të Marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje ratifikohet dhe Shtetet Kontraktuese njoftojnë njëra - tjetrën mbi përmbushjen e kërkesave ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 dhe dispozitat e saj janë në fuqi në të dyja Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim mbi të ardhurat e përfuara në 1 janar ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik të vitit pasardhës në të cilin është bërë njoftimi i fundit;

b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat, për tatimet që caktohen për çdo vit tatimor që fillon në 1 janar ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik pasardhës në të cilin është bërë njoftimi i fundit.

Neni 29

Prishja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa të prishet nga një Palë Kontraktuese. Secila Palë Kontraktuese mund ta prishë Marrëveshjen me rrugë diplomatike, duke bërë njoftim me shkrim për përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të vitit kalendarik që fillon pas periudhës 5-vjeçare

nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në këtë rast, Marrëveshja do të ketë fuqi për të dyja shtetet:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim mbi të ardhurat e përfuara në 1 janar ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik të vitit pasardhës në të cilin është bërë njoftimi i fundit;

b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat, për tatimet që caktohen për çdo vit tatimor që fillon në 1 janar ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik të vitit pasardhës në të cilin është bërë njoftimi i fundit.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Nju-Jork, më 24 shtator 2014, në gjuhën angleze.

PROTOKOLL

Islanda dhe Shqipëria kanë rënë dakord në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes ndërmjet të dyja Shteteve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe mënjanimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, për dispozitat e mëposhtme, që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni shtesë 15

Në paragrafin 2 d) të nenit 15, të punësuarit rezidentë në një Shtet Kontraktues konsiderohen t'u jenë dhënë të tretëve nëse vendosen në dispozicion të një personi tjetër nga një person (agjenti i punësimit) për të kryer punë në aktivitetin e këtij personi tjetër (primari), që gjendet në një Shtet tjetër Kontraktues, me kusht që primari të jetë rezident ose të ketë një seli të përhershme në atë Shtet tjetër dhe që agjenti i punësimit të mos ketë përgjegjësi dhe të mos marrë përsipër ndonjë risk në lidhje me rezultatin e punës.

Për të përcaktuar nëse një i punësuar konsiderohet t'u jetë dhënë të tretëve, duhet të bëhet një hetim i plotë, veçanërisht nëse:

a) kontrolli përfundimtar mbi punën i takon primarit;

b) puna kryhet në një vend pune që është në dispozicion të primarit dhe për të cilin ai ka përgjegjësi;

c) shpërblimi i agjentit të punës llogaritet në bazë të kohës së shpenzuar ose në lidhje me një marrëdhënie tjetër ndërmjet shpërblimit dhe pagave të marra nga të punësuarit;



d) mjetet dhe materialet kryesore sigurohen nga primari; dhe

e) agjenti i punësimit nuk vendos një-anshmërisht për numrin e të punësuarve dhe kualifikimeve të tyre.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në dy kopje në Nju-Jork, më 24 shtator 2014, në gjuhën islandeze.

LIGJ

Nr. 15/2015

PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për marrëdhëniet e Kuvendit me Këshillin e Ministrave dhe me institucionet e Bashkimit European, në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

Neni 3

Fusha e veprimit të ligjit

Ligji e shtrin veprimin e tij mbi funksionet e Kuvendit që kanë të bëjnë me:

a) monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për çështjet e integrimit european;

b) monitorimin e zbatimit të kuadrit normativ që ka të bëjë me integrimin european dhe të fondeve financiare të ofruara nga Bashkimi European;

c) informimin e publikut për ecurinë e etapave të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile të përfshirë në këtë proces.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Çështjet europiane” janë çështjet që dalin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

b) “Dokumente strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale” janë akte të organit publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ku shprehet vullneti dhe parashikimet për zhvillimin dhe realizimin e një politike të caktuar publike në fushat e ekonomisë, zhvillimit social, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, dhe marrëdhënieve me jashtë, të cilat mund të përcaktojnë shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore në një periudhë të caktuar kohore, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në to.

c) “Fondet e Bashkimit European” janë fondet që akordohen nga Bashkimi European për mbështetjen e vendit tonë në plotësimin e kriterëve dhe kushteve për anëtarësimin në Bashkimin European.

ç) “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që ka interesa të përbashkët në fushën e integrimit european, ose subjekte të tjera të interesuara për çështjet e integrimit european.

d) “Institucionet e Bashkimit European” janë institucionet vendimmarrëse të Bashkimit European, si përcaktohen në të drejtën e Bashkimit European.

dh) “Kuadri rregullator i negociatave /bisedimeve për anëtarësim” është kuadri që përcakton parimet dhe udhëzimet për negociatat/bisedimet për anëtarësim, i përgatitur nga Komisioni European, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe i miratuar nga shtetet anëtare të Bashkimit European.



e) “Projektakt” është projekti i një ligji, dokumenti strategjik, si dhe projekte të akteve normative, sipas fushës përkatëse të kompetencave, që kanë të bëjnë me çështje të integritit evropian.

ë) “Legjislacioni i Bashkimit Evropian”, është korpusi ligjor i normave ligjore të detyrueshme dhe të rekomandueshme në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

f) “Plani kombëtar për integrimin evropian, është programi kombëtar i miratuar nga Këshilli i Ministrave, që shërben për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit.

g) “Ministri përgjegjës” është ministri që përgjigjet për çështjet e integritit evropian.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian bazohet në respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të ligjshmërisë, të subsidiaritetit, të proporcionalitetit, të bashkëpunimit reciprok, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë së tregut.

KREU II

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Neni 6

Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian

1. Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian, që ngrihet pranë Kuvendit, i cili nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritit.

2. Këshilli Kombëtar i Integritit drejtohet nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Integritit. Zëvendëskryetar është kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin.

3. Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian përbëhet nga:

a) kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare;

b) përfaqësues të grupeve parlamentare të Kuvendit;

c) kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin;

ç) ministri përgjegjës për integrimin;

d) përfaqësues nga Kabineti i Presidentit;

dh) përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit;

e) përfaqësues nga Ministria e Jashtme;

ë) Prokurori i Përgjithshëm;

f) Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

g) Avokati i Popullit;

gj) tre përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, të përfshira në çështje të integritit evropian.

4. Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian marrin pjesë, me statusin e të ftuarit të përhershëm:

a) titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin;

b) përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe universiteti publik;

c) përfaqësues nga media;

ç) përfaqësues nga organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe sindikatat;

d) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.

5. Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian, sipas tematikës së takimit, fton të marrin pjesë edhe ministrat përgjegjës dhe/ose institucionet e varësisë.

6. Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian organizon takime periodike.

7. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Byroja e Kuvendit.

Neni 7

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Integritit

1. Këshilli Kombëtar i Integritit ka këto përgjegjësi:

a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile, në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

b) siguron diskutim të vazhdueshëm për politikat e integritit evropian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;

c) monitoron zbatimin e detyrimeve për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian;



c) analizon kuadrin ekzistues normativ dhe praktikat, në lidhje me procesin e integritimit europian, për çështjet që merr në shqyrtim;

d) siguron bashkëpunim të vazhdueshëm për procesin e integritimit me komisionet e përhershme parlamentare dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për integrimin europian;

dh) monitoron ecurinë e procesit të negociatave/bisedimeve për anëtarësim;

e) këshillon ose jep opinione lidhur me procesin e negociatave;

ë) mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integrim Europian;

f) zhvillon takime me drejtuesit e grupit negociator dhe drejtuesin e delegacionit shqiptar në negociatat/bisedimet për anëtarësim;

g) raporton të paktën një herë në vit në Kuvend mbi punën e Këshillit;

2. Këshilli harton dhe miraton rekomandimin përkatës për çështjet e shqyrtuara.

3. Rekomandimi u përcillet institucioneve që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjen në fjalë.

4. Gjatë veprimtarisë së tij, Këshilli këshillon për çështje që i vlerëson të rëndësishme për procesin e integritimit europian.

Neni 8

Sekretariati teknik

1. Pranë Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian funksionon sekretariati teknik, që kryen funksione administrative dhe ndihmëse.

2. Sekretariati teknik përbëhet nga përfaqësues të administratës së Kuvendit, që mbulojnë çështjet legjislative, përafrimin e legjislacionit, monitorimin e institucioneve të pavarura dhe shoqërinë civile, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për integrimin, një përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe ekspertë të pavarur për çështjet e integritimit europian.

Neni 9

Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin

1. Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin (Komiteti) është strukturë e përbashkët e Kuvendit dhe Parlamentit Europian që

funksionon sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

2. Komiteti përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Europian dhe anëtarë të Kuvendit, të cilët propozohen sipas përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit për delegacionet e përhershme pranë organizmave ndërkombëtarë. Për atë që është e mundur, anëtarët e këtij Komiteti duhet të jenë anëtarë të Komisionit të Integritimit.

3. Komiteti kryesohet me rotacion nga Parlamenti Europian dhe Kuvendi i Shqipërisë.

4. Komiteti funksionon sipas rregullores së brendshme, të miratuar bashkërisht, dhe vendimmarrja realizohet me konsensus.

5. Kuvendi, në seancën më të parë plenare, informohet pas çdo takimi për të gjitha çështjet e diskutuara dhe konkluzionet e takimit.

Neni 10

Komisioni për Integrimin Europian

Komisioni për Integrimin Europian është organ i përhershëm i Kuvendit, që ka në fushën e përgjegjësisë së tij çështjet e integritimit europian, përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, monitorimin e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe të asistencës financiare të Bashkimit Europian për Shqipërinë.

KREU III

KOMPETENCAT DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Neni 11

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit në çështjet europiane

1. Kuvendi, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, në lidhje me çështjet europiane:

a) monitoron dhe kontrollon zbatueshmërinë e këtij kuadri ligjor në fushën e integritimit europian dhe të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e tij;

b) monitoron punën e Këshillit të Ministrave në lidhje me zbatimin e detyrimeve për procesin e integritimit në Bashkimit Europian;

c) siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian;

ç) shqyrton raportet/konkluzionet e Bashkimit Europian dhe qëndrimet e Republikës së Shqipërisë dhe mund të japë rekomandime mbi to;



d) bashkëpunon me Parlamentin European dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së;

dh) monitoron punën e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, për çështjet e integritimit europian;

e) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

2. Kuvendi, në lidhje me çështjet europiane, angazhohet edhe për:

a) vendosjen e dialogut të përshtatshëm politik ndërmjet palëve në proces;

b) monitorimin e zbatimit të kuadrit rregullator për fillimin e negociatave/bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin European;

c) monitorimin e zbatimit të kuadrit rregullator të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit European e shteteve anëtare, nga ana tjetër;

ç) forcimin e bashkëpunimit rajonal për çështjet e integritimit europian.

Neni 12

Ndërveprimi me institucionet e Bashkimit European

1. Kuvendi merr pjesë në nisma rajonale dhe europiane të bashkëpunimit ndërparlamentar, për çështje të integritimit europian.

2. Kuvendi përfaqësohet në këto marrëdhënie nga anëtarë të tij, të cilët propozohen sipas përcaktimit në Rregulloren e Kuvendit për delegacionet e përhershme pranë organizmave ndërkombëtarë.

Neni 13

Detyrimet e Këshillit të Ministrave në marrëdhëniet me Kuvendin

Këshilli i Ministrave, me kërkesë të Kuvendit, informon mbi punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të Bashkimit European, veçanërisht për:

a) projekt marrëveshjet dhe konventat që duhen miratuar me Bashkimin European, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European;

b) projektaktet që kanë të bëjnë me angazhimet në traktatet e Bashkimit European, me përjashtim të akteve administrative;

c) projektaktet e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe që janë të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë;

ç) projektaktet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të Bashkimit European.

Neni 14

Përgjegjësitë e Komisionit për Integritimin European

Komisioni për Integritimin European, në përmbushje të funksioneve të tij, ushtron edhe këto përgjegjësi:

a) shqyrton, së bashku me komisionet e tjera parlamentare, projektligjet që kanë lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së;

b) monitoron Këshillin e Ministrave /ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritimit për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE;

c) nxit ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritimit europian, që të hartojë dhe të përditësojë planin kombëtar për integritimin europian, si dhe monitoron zbatimin e tij;

ç) monitoron kuadrin e përgjithshëm të bisedimeve për anëtarësim;

d) monitoron, së bashku me komisionet e tjera të përhershme, zbatimin e legjislacionit shqiptar të përafruar me legjislacionin e BE-së;

dh) bashkërendon punën me Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin për të mbajtur marrëdhënie të bashkëpunimit me strukturat e Parlamentit European, si dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së;

e) bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e integritimit europian;

ë) harton dhe shqyrton projektrezoluta lidhur me Planin Kombëtar për Integritimin European;

KREU IV

PJESËMARRJA NË PROCESIN E PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT

Neni 15

Plani Kombëtar për Integritimin European

1. Këshilli i Ministrave depoziton në Kuvend Planin Kombëtar për Integritimin European.

2. Kuvendi, çdo vit, zhvillon një seancë me debat për detyrat që dalin për Kuvendin, të parashikuara në Planin Kombëtar për Integritimin European dhe miraton rezolutën përkatëse.



Neni 16

Lista e projektakteve për përafrim legjislacioni

1. Këshilli i Ministrave, brenda muajit janar të çdo viti, i dërgon Kuvendit, listën e përditësuar të projektligjeve, me qëllim programimin e punës së Kuvendit dhe përcaktimin e procedurave të shqyrtimit, sipas rastit.

2. Komisioni për Integrimin European shqyrton listën e projektakteve që synojnë përputhjen e legjislacioni shqiptar me atë të Bashkimit European dhe, në bashkëpunim me komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushave përkatëse të përgjegjësive, përgatit një raport të posaçëm me rekomandime, të cilat i paraqiten Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Projektligjet e përafrimit të legjislacioni

1. Projektligjet që synojnë përputhjen e legjislacioni shqiptar me atë të Bashkimit European, të paraqitura për miratim në Kuvend, shqyrtohen paraprakisht nga Komisioni për Integrimin European dhe më pas nga komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit, sipas fushës së përgjegjësive.

2. Projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për instrumentet e përafrimit të legjislacioni vendas me atë të Bashkimit European.

3. Organet e Kuvendit, kur konstatojnë mangësi në këtë dokumentacion, i kthejnë Këshillit të Ministrave projektligjin, i cili brenda 15 ditëve duhet të ridërgohet në Kuvend i plotësuar.

4. Ministria përgjegjëse për integrimin european krijon bazën e të dhënave të tabelave të përputhshmërisë të ligjeve të miratuara, e cila përditësohet nga institucionet që kanë të drejtën e iniciativës legjislative.

5. Institucioni propozues i projektligjit duhet të reflektojë në tabelën e përputhshmërisë të gjitha ndryshimet që ka pësuar projektligji, brenda 15 ditëve nga data e publikimit të ligjit të miratuar.

KREU V

RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 18

Raportimi në Kuvend

1. Këshilli i Ministrave, deri më 31 janar të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport të detajuar mbi zbatimin e detyrimeve, sipas Planit Kombëtar për Integrimin European, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi European dhe donatorë të tjerë, për vitin paraardhës. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës Kuvendi miraton rezolutën përkatëse.

2. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se tre javë nga publikimi i Raportit të Progresit të Komisionit European, raporton në Kuvend për gjetjet, rekomandimet, situatën aktuale të zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale të vendit, si dhe për angazhimet konkrete për përmbushjen e rekomandimeve. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës Kuvendi miraton rezolutën përkatëse.

Neni 19

Raportimi në Komisionin për Integrimin European

1. Ministri përgjegjës për integrimin european paraqet në fund të çdo 3-mujori në Komisionin për Integrimin European një raport të hollësishëm mbi:

a) listën e përditësuar të projektligjeve të lidhura me çështjet e integritit european, të cilat do t'i kalojnë për shqyrtim Kuvendit për periudhën vijuese;

b) ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim;

c) raportimet e paraqitura pranë strukturave të Komisionit European apo strukturave të përbashkëta, qëndrimet mbi çështjet e diskutuara, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga këto takime.

2. Me kërkesë të Komisionit për Integrimin European ose të 1/3 së anëtarëve të tij, ministri përgjegjës për integrimin european thirret për të informuar mbi çdo çështje që ka të bëjë me koordinimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.

3. Për zbatimin e planit të veprimeve, të parashikuar në politikat sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara, si dhe për çështje



specifike të fushave të tjera që lidhen me integrimin europian, Komisioni thërret edhe ministrat e përkatës.

Neni 20

Raportimi i institucioneve të pavarura

Komisioni për Integrimin Europian dhe komisionet përgjegjëse, sipas fushave përkatëse të përgjegjësive, mund të thërrasin institucionet kushtetuese të pavarura dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione, në çdo kohë, mbi zbatimin e detyrimeve të procesit të integritit europian dhe zbatimit të kuadrit ligjor përkatës.

Neni 21

Mbikëqyrja e zbatueshmërisë së kuadrit normativ për përafrimin e legjislacionit

1. Komisioni për Integrimin Europian koordinon me komisionet e përhershme të Kuvendit procesin e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së kuadrit normativ, që synon përafrimin e legjislacionit, sipas fushave kryesore të integritit europian.

2. Komisionet e përhershme të Kuvendit, në fund të çdo sesioni parlamentar, u kërkojnë ministrave të linjës të përgatisin një raport lidhur me shkallën e zbatueshmërisë së kuadrit normativ që synon përafrimin e legjislacionit.

3. Raporti, me vlerësimet e komisionit përgjegjës, i dërgohet Komisionit për Integrimin Europian për të përgatitur analiza vlerësuese.

KREU VI

BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Neni 22

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

1. Komisioni për Integrimin Europian dhe komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushës së përgjegjësive, ftojnë grupet e interesit për të marrë pjesë në seanca dëgjimore që lidhen me procesin e integritit, si dhe në procesin e miratimit të kuadrit ligjor që synon përafrimin e legjislacionit.

2. Komisioni për Integrimin Europian mund të organizojë takime të hapura me shoqërinë civile për diskutimin e projektit të Planit të Veprimit të Kuvendit, për zbatimin e masave konkrete, lidhur me përparësitë për integrimin në Bashkimin Europian.

3. Procedurat e detajuara për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 23

Transparenca dhe informimi i publikut

1. Kuvendi përcakton rregullat e bashkëpunimit me shoqërinë civile për të garantuar transparencën e veprimtarisë së tij për çështjet e integritit europian dhe gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit në këtë proces.

2. Kuvendi, në faqen zyrtare të internetit, krijon një rubrikë të veçantë për informimin e publikut për çështjet e integritit europian.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Shfuqizim

Ligji nr. 9252, datë 8.7.2004, “Për punën e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian”, shfuqizohet.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në vitin 5.3.2015

Shpallur me dekretin nr. 8998, datë 17.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 37/2015

PËR EMËRIMIN E ZOTIT PAJTIM MELANI ANËTAR I BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË FUNKSIONIN E KRYETARIT TË BORDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 6, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të nenit 24, “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 54/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pajtim Melani emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në funksionin e Kryetarit të Bordit, me një mandat 4-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 12.3.2015

REZOLUTË

**PËR PARANDALIMIN E
FENOMENIT TË GJAKMARRJES
NË SHQIPËRI**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson se rendi dhe siguria, sundimi i ligjit në çdo pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë është thelbësor për shtetin e së drejtës;

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë drejta themelore që duhet t'i gëzojnë të gjithë shtetasit dhe e drejta e jetës është e drejtë themelore e njeriut të mbrojtur me ligj;

Të ndërgjegjshëm se gjakmarrja dhe hakmarrja janë fenomene primitive, që bien ndesh me ligjin, shtetin e së drejtës dhe frymën e një shoqërie demokratike;

Të vetëdijshëm se parandalimi i hakmarrjes dhe gjakmarrjes kërkon angazhimin e të gjitha institucioneve, në nivel qendror dhe vendor, medias dhe shoqërisë civile;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit në nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nismat që ka ndërmarë për ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe individëve, nëpërmjet raporteve të veçanta dhe rekomandimeve të tij;

Bazuar në Raportin e Veçantë të Avokatit të Popullit për fenomenin e gjakmarrjes në Shqipëri, të depozituar në Kuvend, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë konstaton se:

- Gjakmarrja është një fenomen i lokalizuar në disa zona të Shqipërisë.

- Shpërndarja demografike e fenomenit të gjakmarrjes është kryesisht në zona urbane, edhe

pse ky fenomen është me origjinë rurale. Kjo dëshmon dështimin e mekanizmave dhe instrumenteve urbane të integritit social nga zhvendosja demografike ndër vite, cilësia e edukimit në sistemin shkollor dhe problemet ekonomike të familjes shqiptare.

- Organizmat shtetërore ende nuk kanë arritur të bëjnë përcaktimet e duhura të kësaj situatë të krijuar edhe nga fakti se nuk ka statistika të sakta për këtë fenomen dhe pasojat e tij.

- Të dhënat zyrtare të institucioneve shtetërore për përhapjen e gjakmarrjes dhe për personat e ngjuar për shkak të tij janë kontradiktore. Të dhënat zyrtare për fenomenin e gjakmarrjes nuk përputhen me ato të mbledhura nga organizatat e shoqërisë civile.

- Ligji nr. 9389, datë 4.5.2005, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes", nuk ka gjetur zbatim, për shkak se aktet nënligjore në zbatim të tij nuk janë miraturar.

- Mosfunksionimi i Këshillit Koordinues për këtë çështje për vite me radhë tregon se fenomeni nuk është adresuar si duhet nga institucionet shtetërore, lidhur me parandalimin dhe zhdukjen e fenomenit.

- Programet e parandalimit të gjakmarrjes nuk zbatohen në të gjitha zonat ku fenomeni ka shtrirje gjeografike dhe nuk ka informacion të plotë për programet dhe organizatat që veprojnë në terren për parandalimin e gjakmarrjes dhe pajtimin e palëve.

- Mosparandalimi i konflikteve familjare, të pronësisë, hasmërive të vjetra, si dhe atyre me motive të tjera të dobëta kanë ndikuar në kryerjen e veprave penale për hakmarrje dhe gjakmarrje.

- Ministria e Arsimit dhe e Sporteve ka zbatuar programe mësimore të posaçme për arsimimin e fëmijëve të ngjuar, por këto programe ofrojnë dije të reduktuara, jashtë standardeve normale të arsimit.

- Niveli i ulët i rasteve të proceduara dhe të dënuara për vepra penale me motive gjakmarrjeje dhe hakmarrjeje është tregues i një politike penale joefektive për parandalimin dhe dënimin e këtij fenomeni.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i kërkon:



- Qeverisë, që organet e administratës publike të vlerësojnë seriozisht fenomenin e gjakmarrjes, të forcojnë bashkëpunimin dhe të bashkërendojnë mes tyre dhe me organizatat joqeveritare për parandalimin e gjakmarrjes dhe hakmarrjes.

- Institucionit të Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit, që të koordinojnë punën e tyre dhe të zhvillojnë hetime më të shpejta, të plota dhe objektive, duke zbatuar një politikë penale efektive, ndaj personave që përfshihen në vepra penale të gjakmarrjes ose hakmarrjes.

- Organeve të Policisë së Shtetit, që të marrin masa për parandalimin e konflikteve, për zbulimin dhe dërgimin e personave të akuzuar tek organi e prokurorisë, duke forcuar bashkëpunimin me organet homologe dhe me Interpolin për ekstradimin e personave në kërkim ose të dënuar nga gjykatat shqiptare për veprat penale me motive gjakmarrjeje ose hakmarrjeje.

- Këshillit Koordinues në Luftën Kundër Gjakmarrjes funksionimin, me qëllim hartimin e një strategjie kombëtare në luftën kundër gjakmarrjes, marrjen e masave në planin ekonomik, social dhe legjislativ dhe përgatitjen e akteve nënligjore për funksionimin e këtij këshilli.

- Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për të rritur rolin informues dhe edukues mes përmirësimit të programeve mësimore dhe veprimtarive edukative, që synojnë edukimin me frymën e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, gjakmarrjes dhe hakmarrjes, si dhe të vlerësohet krijimi i lehtësive për arsimtarët që përfshihen në programet mësimore të edukimit të fëmijëve të ngjuar.

- Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që të përfshihet specifikisht, nëpërmjet zyrave rajonale të saj, për të ndihmuar familjet e ngjuara, me të ardhura të pamjaftueshme, nëpërmjet programeve të posaçme të ndihmës ekonomike dhe mundësitë e ofrimit të punësimit të tyre.

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson nevojën e ndryshimeve, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues për parandalimin dhe zhdukjen e këtij fenomeni primitiv. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkon angazhimin e të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, medias dhe shoqërisë civile të veprojnë bashkërisht për dhënien fund të plagës sociale të gjakmarrjes.

Miratuar në datën 5.3.2015

KRYETARI
Ilir Meta

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 175 lekë